



Qendra e Trajnimeve & Burimeve për Avokim

# AVOKUESI



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERICKOG NARODA

Perkrah  
komunitetin e OJQ-ve



Vëllimi IV • Numri 10 • Dhjetor 2006

## PËRMBAJTJA

### Faqe 2

Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut publikoi raport për mediat e shkruara në Kosovë

OJQ e re themelohet në Mitrovicë, synon kthimin e të zhvendosurve

Gazetarët e Kaçanikut formojnë klub

### Faqe 3

Shoqëria civile formon Koalicionin Kosovor Antikorrupsion

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut organizoi Festivalin Ndërkombëtar të Filmit Dokumentar për të Drejtat e Njeriut

Studentët e Shkollës Kosovare për Integrime Evropiane mësuan nga përvojat rajonale për procesin e integritimit në BE

### Page 4

Rrjeti Ballkanik për të Drejtat e Njeriut publikoi librin e vitit 2006 mbi të drejtat e njeriut

Shtëpia e të Drejtave të Njeriut themelohet në Maqedoni

Parlamenti mban seancë të hapur dëgjimore për të drejtat e fëmijëve në Shqipëri

**Mundësi të reja financimi, lajme, aktivitete, trajnime, etj**

mund të lexoni në web faqen e ATRC-së: [www.advocacy-center.org](http://www.advocacy-center.org)

## Mundësi financimi për OJQ-të

### ATRC-ja bën thirrje për propozime nga OJQ-të për Grantet e Partneritetit dhe Rrjetëzimit

ATRC-ja më 1 dhjetor ka shpallur konkurs për OJQ-të kosovare për rundin e katërt të granteve për Partneritet dhe Rrjetëzim në kuadër të Programit Kosovar për Shoqërinë Civile të IREX-it. Grantet për Partneritet dhe Rrjetëzim do t'u ndahen OJQ-ve, projekt-propozimet e të cilave përmbajnë komponentë të fuqishëm partneriteti dhe rrjetëzimi ndërmjet OJQ-ve, OJQ-ve dhe sektorëve të tjerë (qeveria lokale ose qendrore, bizneset private). Projektet po ashtu duhet të adresojnë çështje të rëndësishme në njërin nga tri fushat e granteve: Transparenca dhe Anti-korrupsioni, Zhvillimi i Komunitetit ose Pajtimi Ndëretnik dhe

Zgjidhja e Konfliktit. Kohëzgjatja e këtyre granteve është 6-9 muaj. OJQ-të mund të aplikojnë për grant deri në \$ 25,000. *Afati i fundit për dorëzim të projekteve është 15 dhjetori, 2006.* Dokumentet gjithëpërfshirëse dhe të hollësishme të konkursit (përfshirë përshkrimin e programit, kriteret e ndarjes së granteve, afatet kohore për aplikim, kriteret e përzgjedhjes dhe procesi i shqyrtimit, format e kërkuara për aplikim si dhe formati dhe udhëzuesi i propozimit) mund të merren në ATRC, rruga Agim Rramadani, Nr.15, Prishtinë ose të shkarkohen nga faqja e Internetit e ATRC-së [www.advocacy-center.org](http://www.advocacy-center.org). Programi Kosovar për Sho-

qëri Civile (KCSP) është iniciativë trivjeçare e financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe e implementuar nga Bordi Ndërkombëtar për Hulumtime dhe Shkëmbime (IREX). Qëllimi i programit është zhvillimi i mëtejshëm i shoqërisë civile dhe komunitetit të OJQ-ve në Kosovë, që të jetë sektor i qëndrueshëm dhe të luan rol domethënës në përfaqësimin e dallimeve qytetare si dhe në formësimin e politikave publike.

*Për më shumë informata, kontaktoni 038 244 810 ose [grants@advocacy-center.org](mailto:grants@advocacy-center.org).*

## Shoqëria civile dhe qeveria diskutuan për decentralizimin në Deçan

ATRC-ja në bashkëpunim me OJQ-në nga Deçani, "Epoka e Re", organizoi më 24 nëntor diskutim publik për procesin e decentralizimit në komunën e Deçanit. Pjesëmarrës ishin Ministri i Ambientit dhe Planifikimit Ardian Gjini, Kryetari i Komunës së Deçanit Nazmi Selmanaj dhe përfaqësues të shoqërisë civile nga rajoni i Deçanit.

### Vazhdon në faqen 2



*Përfaqësues të qeverisë qendrore dhe lokale dhe shoqërisë civile diskutuan për procesin e decentralizimit në Komunën e Deçanit më 24 nëntor*

Publikimi i këtij buletini mundësohet nga përkrahja zemërgjerë e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e ATRC-së dhe nuk reflekton detyrimisht qëndrimet e USAID-it ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

## OJQ të Reja

### OJQ e re themelohet në Mitrovicë, synon kthimin e të zhvendosurve

"Bregu i Veriut" është themeluar në nëntor për të kthyer personat e zhvendosur në shtëpitë e tyre në pjesën veriore të Mitrovicës. Musa Miftari, kryesues i organizatës, ka deklaruar se "Bregu i Veriut" do të kërkoj ndihmë nga qytetarët, institucionet qeverisëse, shoqëria civile dhe institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare për të mundësuar kthimin gradual të të gjithë qytetarëve në pronat e tyre në pjesën veriore të Mitrovicës.

### Gazetarët e Kaçanikut formojnë klub

Gazetarët e Komunës së Kaçanikut kanë themeluar klubin e tyre më 19 nëntor, i cili do t'i mbroj të drejtat dhe dinjitetin e gazetarëve lokal, promovoj mediat e lira dhe shtoj transparencën publike. Gazetarët e Kaçanikut shqyrtuan dhe miratuan statutin e klubit dhe zgjodhën Kjani Sallahun kryesues të tyre.



## Shoqëria civile dhe qeveria diskutuan për decentralizimin në Deçan

### Vazhdon nga faqja 1



Fshatarët e Sllupës, Vokshit dhe Rastavicës shprehën shqetësimet e tyre tek Ministri Ardian Gjini më 24 nëntor për Pilot Projektin për Komunën e Junikut

Banorët e fshatrave Sllup, Voksh dhe Rastavicë shprehën shqetësimet e

afron shërbimet publike më pranë fshatarëve", ka thënë Nezir Panxhja,

tyre për planet që këto fshatra të përfshihen në Pilot Projektin Komunal të Junikut. "Pilot projekti aktual nuk ju shërben nevojave të fshatarëve të Sllupës, Vokshit dhe Rastavicës. Ai nuk i

kryesues i fshatit Voksh.

Ministri Gjini, po ashtu anëtar i ekipit negociator për statusin e ardhshëm politik të Kosovës, i siguroi qytetarët e Deçanit se zëri i tyre dëgjohej. Ai u zotua se shqetësimet e tyre do të merren parasysh dhe do të shqyrtohen me Lutfi Hazirin, Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i Pushtetit Lokal.

Diskutimi është përkrahur financiarisht nga Trusti Ballkanik për Demokraci (BTD).

Për më shumë informata kontaktoni [info@advocacy-center.org](mailto:info@advocacy-center.org).

### Monitorimi i mediave

## Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut publikoi raport për mediat e shkruara në Kosovë

Gjatë periudhës prej 1 gushtit deri më 15 tetor, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YIHR) ka monitoruar nëntë gazeta ditore të Kosovës për të ekzaminuar shkrimet për një sërë çështjesh relevante për shoqërinë kosovare. Monitorimi i mediave po ashtu ka synuar hetimin dhe ekzaminimin e efekteve që mund të ketë për opinionin publik një këndvështrim i caktuar i të raportuarit nga ana e mediave.

Gazetat e monitoruara janë *Koha Ditore*, *Express*, *Zëri*, *Kosova Sot*, *Bota Sot*, *Epoka e Re*, *Lajm*, *Iliria Post* dhe *Pavarësia News*.

Monitorimi është përqendruar në bisedimet ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit lidhur me statusin e ardhshëm politik të Kosovës, posaçërisht në çështjen e decentralizimit dhe të drejtat e

komuniteteve.

"Përqendrimi në këto negociata është bërë për faktin se në bisedime përfshihen çështje me rëndësi jetike për qytetarët dhe të ardhmen e Kosovës", thuhet në raportin e YIHR-së.

Raporti po ashtu analizon

kualitetin e raportimit nga mediat kosovare, sikurse edhe nivelin e (jo)profesionalizmit.

"Ka nevojë për përmirësim të metodave të përdorura nga gazetarët në shkrimin e artikujve. Bëhen gabime elementare siç është përdorimi i vetëm një burimi informacioni në shkrimin e artikullit, gjë që bie në kundërshtim me parimet bazë të raportimit të balancuar", thuhet në raport.

"Megjithatë, ekziston një tendencë pozitive në mediat kosovare që minoritetet t'u jepet hapësirë e mjaftueshme për ti shprehur në mënyrë të barabartë mendimet, ndjenjat dhe qëndrimet e tyre", vazhdon raporti. Për më shumë informata, kontaktoni 038 244 517 ose [ksoffice@yih.org](mailto:ksoffice@yih.org).



### Studentët e Shkollës Kosovare për Integritim Evropian mësuan nga përvojat rajonale për procesin e integritimit në BE



Përfaqësues nga Kroacia, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi dhe Sllovenia këmbyen përvojat e fituara gjatë procesit të integritimit në Bashkimin Evropian (BE) me studentët të Shkollës Kosovare për Integritim Evropian, gjatë një seminari rajonal të organizuar më 24-25 nëntor nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile.

Studentët u njoftuan për zhvillime të caktuara në kuadër të integritimeve në BE të Evropës Juglindore, përfshirë rrugën e Kroacisë drejt BE-së, perspektivën e Shqipërisë në integrimin evropian, përvojën e Maqedonisë si vend kandidat, Mali i Zi në procesin e integritimit si dhe Sllovenia dhe BE-ja.

Pjesëmarrësit rajonal veçuan gabimet e vendeve të tyre gjatë procesit të integritimit të BE-së. Ata i këshilluan kosovarët që të mos i përsërisin gabimet e njëjta.

"Detyra e kosovarëve është që sa më parë të jenë të gatshëm për të qenë në dyert e BE-së dhe në këtë shtegtim Kosova është në rrugë të mbarë", ka deklaruar Kryeministri Agim Çeku.

*Për më shumë informata, kontaktoni [office@kcsfoundation.org](mailto:office@kcsfoundation.org).*

## Transparenca dhe antikorruptsi

### Shoqëria civile formon Koalicionin Kosovar Antikorruptsi

Gjashtëdhjetë përfaqësues të shoqërisë civile themeluan Koalicionin Kosovar Antikorruptsi gjatë një seminari për transparencë dhe antikorruptsi të organizuar më 1-2 dhjetor në Prizren nga ATRC-ja, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Agjencioni Kosovar për Antikorruptsi.

Sipas organizatorëve, seminari synonte mbledhjen, fuqizimin dhe përkrahjen e shoqërisë civile në luftimin e korrupsionit në Kosovë.

Pjesëmarrësit po ashtu shqyrtuan një sërë temash që kanë të bëjnë me transparencën dhe antikorruptsin, siç janë roli i shoqërisë civile në ngritjen e transparencës, llogaridhënies institucionale dhe kapaciteteve për të luftuar korrupsionin;

rëndësia e ndërtimit të koalicionëve; avokimi si metodë në luftimin e korrupsionit; dhe hulumtimet e fundit për perceptimet e njerëzve ndaj transparencës në Kosovë.

"Kosova ka nevojë të ketë koalicion të fortë të përbërë nga organizata të ndryshme të shoqërisë civile në luftimin e korrupsionit. OJQ-të e bashkuara në një koalicion, do të luanin rol të rëndësishëm në komunitet, duke bërë presion dhe shërbyes si 'watchdog' të reformave institucionale", ka theksuar Rreze Duli, drejtoreshë e ATRC-së.

"Për shkak të mungesës së bashkëpunimit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile në luftimin e këtij fenomeni që ndikon në zhvillimin e Kosovës, UNDP-ja dhe

ATRC-ja organizuan këtë seminar i cili rezultoi me formimin e një koalicioni të ri antikorruptsi të shoqërisë civile", ka thënë Evliana Berani, përfaqësuese e UNDP-së.

Koalicioni i ri ka zgjedhur këshillin menaxhues dhe ka miratuar aktet normative të Koalicionit Kosovar Antikorruptsi.

Seminari është pjesë e "Iniciativës Kosovare për Transparencë" të UNDP-së, e cila përfshinë aktivitete avokimi, hulumtime dhe trajnime për antikorruptsi dhe transparencë me qëllim të luftimit të korrupsionit në Kosovë.

*Për më shumë informata, kontaktoni [info@advocacy-center.org](mailto:info@advocacy-center.org).*

## Të drejtat e njeriut

### Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut organizoi Festivalin Ndërkombëtar të Filmit Dokumentar për të Drejtat e Njeriut

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ) prej 5 deri më 10 dhjetor organizoi në Prishtinë Festivalin e shtatë Ndërkombëtar të Filmit Dokumentar për të Drejtat e Njeriut.

Të ndarë në disa kategori, tridhjetë filma për të drejtat e njeriut nga pjesë të ndryshme të botës u shfaqën në kinemanë ABC 1 gjatë festivalit "Një Botë". Njëmbëdhjetë prej tyre ishin filma kosovar.

Në kuadër të festivalit u organizuan diskutime publike ndërmjet grupeve të ndryshme për tema siç janë paanshmëria në gazetari, të drejtat e grave, të drejtat

e fëmijëve dhe problemet në mes të aktivistëve të "Vetëvendosjes" dhe Shërbimit Policor të Kosovës.

"Festivali Ndërkombëtar i Filmit Dokumentar për të Drejtat e Njeriut 'Një Botë' po e fiton statusin e një festivali tradicional", ka thënë Pajazit Nushi, kryetar i KMDLNJ-së. Sipas tij, publiku kosovar gjithnjë e më shumë po shton interesimin për të drejtat e njeriut. "Pamjet vizuele dhe zanore për të drejtat e njeriut të shoqëruara me komente dhe shpjegime të shkurtra po tregohen më të fuqishme se format e tjera të zhvillimit të kulturës për mbrojtjen e të drejtave dhe

lirive të njeriut", ka pohuar Nushi.

*Për më shumë informata, vizitoni [www.cdhrf.org](http://www.cdhrf.org).*



*"Sekreti gjerman (në foto)" dhe "Hetimet s'vazhdojnë" janë shpallur dy filmat më të mirë dokumentarë të festivalit më 10 dhjetor*



**Executive Director**  
RREZE DULI  
rreze@advocacy-center.org

**Financial & Administration  
Manager**  
GANI ASLLANI  
gani@advocacy-center.org

**Grant Manager**  
TEUTA LUXHA  
teuta@advocacy-center.org

**Grant Officer**  
KUSHTRIM KALOSHI  
kushtrimk@advocacy-center.org

**Grant Officer**  
XHAFER AHMETI  
xhafer@advocacy-center.org

**Training & Consultancy  
Services Manager**  
DONIKA SALIHU  
donika@advocacy-center.org

**Trainer & Consultant**  
AFERDITA SURROI  
aferdita@advocacy-center.org

**Trainer & Consultant**  
KUSHTRIM ISLAMI  
kushtrim@advocacy-center.org

**Trainer & Consultant**  
NORA SUSURI  
nora@advocacy-center.org

**Communication & Outreach  
Manager**  
ARJETA DOROCI  
arjeta@advocacy-center.org

**Program Officer**  
NATYRA ZHJEQI  
natyra@advocacy-center.org

**IT and Database Manager**  
ARSIM KOSUMI  
arsim@advocacy-center.org

Rr. Agim Ramadani Nr. 15  
Kati i 2-të Prishtinë, Kosovë  
Telefon/Fax: +381 (0) 38 244  
810

## Zhvillime rajonale për të drejtat e njeriut

### Publikim i ri


## Rrjeti Ballkanik për të Drejtat e Njeriut publikoi librin e vitit 2006 mbi të drejtat e njeriut

Rrjeti Ballkanik për të Drejtat e Njeriut (RrBDN) ka publikuar në dhjetor edicionin e gjashtë të librit vjetor për të drejtat e njeriut. Çdo vit RrBDN-ja zgjedh një temë aktuale për publikun në Ballkan. Tema e këtij viti është "Anëtarësimi në BE dhe të Drejtat e Njeriut - Pasojat, Tendencat dhe Roli i Shoqërisë Civile".

Libri vjetor i RrBDN-së për të drejtat e njeriut është përmbledhje e eseve të shkruara nga ekspertë të njohur rajonal të cilët kontribuuan me analizat dhe opinionet e tyre për temën e dhënë. "Anëtarësimi në BE dhe të Drejtat e Njeriut - Pasojat, Tendencat dhe Roli i Shoqërisë Civile" po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm me afrimin e datës së anëtarësimit të Rumanisë dhe Bullgarisë në BE. Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor dëshirojnë të bëhen anëtare të BE-së por shpesh perspektiva e të drejtave të njeriut në këtë proces anashkalohet", thotë RrBDN-ja.

Publikimin e plotë mund ta merrni nga <http://www.balkan-rights.net/bhrn/content/view/178/45/>. Faqja e Internetit e RrBDN-së është [www.balkan-rights.net](http://www.balkan-rights.net). Burimi: *Balkan Academic News*

## Shtëpia e të Drejtave të Njeriut themelohet në Maqedoni



Shkupi, kryeqyteti i Maqedonisë

Shkup më 28 nëntor. Ajo synon të përshpejtoj zhvillimin e shoqërisë civile dhe të ngrit kapacitetet e organizatave civile në Maqedoni.

Shtëpia maqedonase e të Drejtave të Njeriut është pjesë e rrjetit ndërkombëtar të shtëpive për të drejtat e njeriut me seli në Oslo të Norvegjisë. Rrjeti përfaqëson disa OJQ, misioni i përbashkët i të cilave është promovimi i të drejtave të njeriut brenda dhe jashtë vendeve të tyre.

"Shtëpia në Maqedoni do të

shërbej si qendër kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe zhvillimin e shoqërisë civile", ka deklaruar Dragi Zmijnac, kryetar i Shtëpisë. "Kjo shtëpi po ashtu synon të shtoj bashkëpunimin ndërmjet aktiviteteve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut për t'i ndihmuar qytetarët në praktikimin e të drejtave dhe nevojave të tyre".

Maqedonia është vendi i 13 në botë që ka hapur një degë të Rrjetit të Shtëpive për të Drejtat e Njeriut.

Burimi: *Macedonian News*

Shtëpia e të Drejtave të Njeriut është themeluar në

## Parlamenti mban seancë të hapur dëgjimore për të drejtat e fëmijëve në Shqipëri

Nën-komisioni Parlamentar për të Miturit dhe Mundësi të Barabarta në bashkëpunim me Qendrën për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri (CRCA), ka organizuar më 21 nëntor një seancë të hapur dëgjimore për të drejtat e fëmijëve në vend, të përcjellur nga më shumë se 30 përfaqësues të OJQ-ve, shoqërisë civile, dhe mediave.

Altin Hazizaj, drejtor i CRCA-së, komentoi se kjo seancë nënkupton traditë të re për parlamentin shqiptar, i

cili përmes këtyre seancave të hapura dëgjimore ka mundësi të njihet më mirë për problemet e fëmijëve dhe në të njëjtën kohë të konsultohet më OJQ-të dhe shoqërinë civile.

Është rënë dakord që Nën-komisioni për të Miturit të zhvillojë një herë në vit seancë të ngjashme për të drejtat e fëmijëve. Përfaqësues të qeverisë garantuan se ky nën-komision do të vazhdojë të përkrah të gjitha iniciativat e OJQ/shoqërisë

civile për përmirësimin e legjislacionit që ka të bëjë me fëmijët në Shqipëri.

Për të lexuar më shumë për CRCA-në vizitoni <http://www.crca.org.al>.

